



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 58 dt. 15.09.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 15.09.2014, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Lidhur me projektin e Portit të Jahteve, Kalaja e Turrës, Synej, Kavajë. (kërkesë nga shoqëria FINSEC sh.a),

Miratohet Faza e Parë - Ndërtimi i Portit.

Në këtë fazë të mos bëhet asnjë ndërhyrje e karakterit ndërtimor që parashikon projekti në zonën me gjetje intensive arkeologjike, konkretisht në pjesën veriore të kepit të Lagjit me koordinatat 41° 8'43, 82''N dhe 19° 26'14, 57''E, Zona 6 në projekt dhe pesë godina 2kt me nr rendor 57,58.

2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore punimet të mbikqyren nga specialistë të IMK dhe ASHA.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI